



Informata mbi Vaksinimin-Covid-19

Vaksinimi bazë: Në përdorim janë tre vaksina të toleruara mirë: **Pfizer, Moderna** dhe **Janssen**. Tek **Pfizeri dhe Moderna** si Vaksinim bazë nevoiten dy Vaksinime në distancë kohore prej katër javësh, ndërsa nga **Janssen** mjafton vetëm një Vaksin. Pas kësajë keni një mbrojtje të mirë prej 90% kundër sëmundjes për disa muaj.

Vaksinimi përforcues: Ky vaksinim është i rëndësishëm pasi që mbrojtja e vaksinimit tek vaksinat e lartëpërmendura dhe sidomos mbrojtja kundër variantave të reja, pas disa muajëve dobësohet. Nëse kanë kaluar më shumë se 4-6 muaj nga vaksinimi i fundit me **Pfizer** ose **Moderna**, atëherë ju rekomandojmë të bëni një **vaksinim përforcues=Booster** tek të dy vaksinat (Pfizer nga mosha 16 vjeçe, Moderna nga mosha 18 vjeçe). Sipas rregullit, do të rivaksinoheni me të njëjtën vaksin që keni patur në fillim. Nëqoftëse jeni vaksinuar me **Janssen** atëherë ju rekomandojmë vaksinim përforcues nga e njëjta vaksin, 2 muaj pas vaksinimit të parë nga mosha 18 vjeçare.

Sipas përvojave të deri mëtanishme këto vaksina tolerohen mirë. Efekte anësore më të shpeshta janë: dhimbje të lehta në vendin e injektimit, lodhje, dhimbje të kokës dhe të gjymtyrëve, eventualisht temperaturë. Rrallëherë mund të vij deri te ndezja e muskujve të zemrës, pa pasoja të rënda e sidomos tek të rinjtë nën moshën 30 vjetçare. Efekte anësore të rënda dhe afatgjate si dhe pasoja të më vonshme deri më tani nuk janë paraqitur dhe nuk pritet që të paraqiten.

Efektet anësore janë zhakonisht të lehta dhe nuk zgjasin gjatë. Këto efekte anësore janë shumë më të dobta sesa pasojat e sëmundjes së Koronës nëse smureni.

Edhe pse Vaksinimi mbron mirë nga sëmundja është e rëndësishme, që të vazhdoni t'iu përmbaheni rregullave të rekomanduara për higjenë dhe sjellje.

Ne dëshirojmë që së fundmi ta tejkalojmë pandeminë dhe t'i rikthehemi normalitetit të jetës. Për këtë na duhen vaksinimet.

Vaksinohuni! Ne ju mirëpresim në Qendrën e vaksinimit Charlottenfels. Është shumë e thjeshtë dhe e lehtë të merrni vaksinimin. Më së miri e keni të paraqiteni për të lënë takim.

Me respekt

Ekipa e vaksinimit Covid/19

Si mund të vaksinohem?

Ju lutemi merreni kartelën e identifikimit, kartën e vaksinimit (nëse e posedoni) dhe kartelën e sigurimit me veti.

Regjistrim i rregullt nëpërmes internetit: **sh.ch**

Ose paraqituni në numrin e Telefonit **052 632 65 57**

Vaksinimi pa termin në: Walk-in të Martën 17 – 20 Uhr

Kjo është e mundur vetëm për vaksinimin e 1-rë dhe 2-të, por JO edhe për Vaksinimin përforcues!